



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA SHKODËR**

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër, ëeb: ëëë.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al, Tel: +35522400150

## **Raporti teknik**

**Objekti** :Shërbimi I Pastrimit Bashkia Shkodër , zona Perendimore

**Burimi I financimit** :Buxheti i Bashkise me VKB nr 26 datë 30.12.2019 “Për zbatimin e Buxhetit 2020-2022 dhe Programit buxhetor të Bashkisë Shkodër

**Afati i realizimit** : 36 Muaj

**Fondi total** : 63 908 816.16 lekë pa TVSH dhe 76 690 579.39 lekë me TVSH.

**Vendodhja** :Njësitë Administrative Velipoje, Dajc, Berdice, Ana Malit.

### **Gjendja aktuale.**

Aktualisht shërbimi në zonën Perndimore ka dy kontrata, ku Nj.A Velipoje dhe Dajc janë në një kontratë dhe Nj.A Berdice dhe Ana Malit është në një kontrate tjeter..

Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve deri me tani ka pergjithsuar kryerjen e këtyre aktiviteteve:

- Organizimin ditor të shërbimeve të grumbullimit të mbetjeve,
- Transportit dhe depozitimit të mbetjeve

### **Objektivi**

Shërbimit të Pastrimit do ti shtohen aktivitetet si më poshtë:

- Organizimin më i detajuar ditor të shërbimeve të grumbullimit të mbetjeve,
- Klorifikimi I PGM dhe I kazaneve
- Mirembajtjen e kazaneve dhe pastrimi I sipërfaqes përreth pikës së grumbullimit.
- Perfeksionim I shërbimit te pastrimit ne Plazhin e Velipojes, duke rritur numrin e pikave te grumbullimit , si dhe organizim me biznesin privat per ndarjen e mbetjeve nga ato materiale qe riciklohen.

Pra si objektiv kryesor kemi,përmisimi i cilësisë së shërbimit te menaxhimit te mbetjeve në zonën Perndimore nëpërmjet rritjes së performances në mbledhjen , transportin dhe depozitimin e sigurtë tëmbetjeve ë Landfillin Bushat si dhe duke e shtrire ate ne pershtatje me “Planin Lokal te Menaxhimit te Integruar te Mbetjeve te Ngurta Urbane” te miratuar.